VENDIM
Nr.15, datë 5.3.2007

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA "EMIKEL 2003" SHPK TE SHOQËRIA "EMIKEL" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet përkatëse, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004 "Për ndërtimin, instalimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike" pika 1.4, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.6, datë 16.2.2006 "Miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë "Emikel 2003"" sh.p.k., Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi verifikoi proceset ligjore të shoqërisë "Emikel 2003" sh.p.k.,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.6, datë 16.2.2006 "Miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë "Emikel 2003" sh.p.k".
- Licenca e miratuar me vendimin nr.6, datë 16.2.2006 për shoqërinë "Emikel 2003" sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Lenie (Gramsh), Çorovodë (Skrapar) dhe Tuçep (Bulqizë) t'i transferohet shoqërisë "Emikel" sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta